

VENDIM
Nr. 294, datë 17.5.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE, PËR PARAQITJEN
E KËRKESAVE, PËR TË VEPRUAR SI ADMINISTRATOR NË PROCEDURAT E
FALIMENTIMIT, SI DHE PROCEDURËN PËR DHËNIEN E HEQJEN E
LICENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 42, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i kriterëve dhe rregullave të hollësishme për mënyrën e paraqitjes dhe trajtimit të kërkesave për të vepruar si administrator, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, si dhe procedurës për dhënie e heqjen e licencës.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrator”, administratori i përkohshëm, administratori mbikëqyrës dhe administratori i falimentimit.
2. “Administrator i falimentimit”, administratori i caktuar nga gjykata e falimentimit në vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit ose pas hapjes së saj kur zëvendëson debitorin në administrimin dhe drejtimin e veprimtarisë.
3. “Agjencia Kombëtare e Falimentimit”, autoriteti shtetëror kompetent për mbikëqyrjen, trajnimin dhe licencimin e veprimtarisë së administratorëve.
4. “Kandidat”, individ që paraqet kërkesë pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit për t’u licencuar si administrator.
5. “Licencë”, akti administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë profesionin e administratorit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
6. “Provimi i kualifikimit”, testimi i njohurive të kandidatëve që përmbushin kriteret për të qenë pjesë e tij, kalimi me sukses i të cilit mundëson ushtrimin e funksionit të administratorit.
7. “Regjistri i administratorëve”, regjistri i administratorëve të certifikuar të falimentimit, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

KREU II
KRITERET DHE PROCEDURA PËR DHËNIEN E LICENCËS

SEKSIONI 1
KRITERET E PËRZGJEDHJES DHE PARAQITJA E KËRKESAVE

Neni 3
Kriteret e përzgjedhjes

Kandidati duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë të studimeve ose ekuivalente me të në shkenca ekonomike ose drejtësi;
- ç) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në shkenca ekonomike ose drejtësi;
- d) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
- dh) të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose i funksionit publik për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur kjo masë disiplinore është shuar sipas legjislacionit të posaçëm;
- e) të ketë kryer me sukses provimin e kualifikimit;
- ë) të ketë kryer pagesën e tarifës për pajisjen me licencë, sipas pikës 3, të nenit 23, të këtij vendimi.

Neni 4

Publikimi i thirrjes

1. Thirrja për shprehje interesi hapet të paktën 2 (dy) herë në vit dhe publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

2. Thirrja qëndron e hapur për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e publikimit.

Neni 5

Paraqitja e kërkesës për shprehje interesi dhe dokumentacioni shoqërues

1. Kandidati paraqet kërkesën për shprehje interesi elektronikisht nëpërmjet shërbimit elektronik në portalin qeveritar “*e-Albania*” dhe ngarkon elektronikisht dokumentacionin shoqërues, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të publikimit të përcaktuar në nenin 4, të këtij vendimi.

2. Trajtimi i kërkesës për shprehje interesi dhe verifikimi i kriterëve të kandidatëve kryhet nga struktura përgjegjëse për licencimin e administratorëve pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

3. Kandidati depoziton kërkesën e tij të shoqëruar me këto dokumente:

- a) jetëshkrim;
- b) kërkesë për shprehje interesi;
- c) vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore;
- ç) kopje të njësuar të diplomës së ciklit të dytë të studimeve ose ekuivalente me të, lëshuar nga një institucion arsimor i akredituar në Republikën e Shqipërisë ose nga një institucion arsimor i huaj, të njohur e të njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- d) kopje të njësuar të librezës së punës ose çdo vërtetim tjetër, të lëshuar nga një autoritet shtetëror, që provon përvojën e punës në shkenca ekonomike ose drejtësi;
- dh) vërtetim për pagesën e tarifës së provimit të kualifikimit për llogari të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

4. Paraqitja e kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese kryhet në rrugë elektronike, përmes portalit qeveritar “*e-Albania*”.

5. Kandidati është përgjegjës personalisht për vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentacionit, të depozituar pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

Neni 6

Verifikimi paraprak

Struktura përgjegjëse për licencimin e administratorëve, pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, administron shprehjet e interesit dhe dokumentacionin shoqërues të kandidatit dhe, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e tyre, kryen veprimet e mëposhtme:

a) kur shprehja e interesit dhe dokumentacioni shoqërues është në përputhje me nenin 5, të këtij vendimi, njofton kandidatin, përmes portalit qeveritar “*e-Albania*” në rubrikën “Hapësira ime”, për vazhdimin e procedurës së verifikimit të kritereve;

b) kur shprehja e interesit dhe dokumentacioni shoqërues nuk është në përputhje me nenin 5, të këtij vendimi, njofton kandidatin, përmes portalit qeveritar “*e-Albania*” në rubrikën “Hapësira ime”, për plotësimin e të metave brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit. Struktura përgjegjëse ndihmon në mënyrë aktive kandidatin për plotësimin e të metave të konstatuara. Mosplotësimi i të metave brenda afatit 5-ditor përbën shkak për mospranimin e kërkesës.

Neni 7

Verifikimi i kritereve

1. Struktura përgjegjëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi për vazhdimin e procedurës së verifikimit ose përfundimit të afatit për plotësimin e të metave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kriteret për të vepruar si administrator, në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kritereve për të vepruar si administrator, nuk është i plotë e i saktë ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, struktura përgjegjëse mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga çdo organ publik apo persona të tjerë juridikë, vendas ose të huaj.

3. Në përfundim të verifikimit për plotësimin e kritereve për të vepruar si administrator, struktura përgjegjëse harton relacionin shpjegues për secilin kandidat, ku pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe arsyet për pranimin ose rrëzimin e kërkesës, si dhe njoftimin përkatës.

Neni 8

Ankimi ndaj refuzimit të kërkesës

1. Kandidatët, të cilëve u është refuzuar kërkesa, kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë ministrit të Drejtësisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, duke bashkëlidhur argumentet dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kritereve ligjore.

2. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë shqyrton ankimin dhe i propozon ministrit të Drejtësisë përfshirjen në listën e kandidatëve të kualifikuar, në rastet kur provohet përmbushja e kritereve për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit ose skualifikimin përfundimtar të tij nga pjesëmarrja në provim. Ministri i Drejtësisë nxjerr urdhrin përkatës jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së ankimit.

3. Ndaj urdhrit të ministrit për skualifikimin e kandidatit mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

SEKSIONI 2

ORGANIZIMI I PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT

Neni 9

Provimi i kualifikimit

1. Provimi i kualifikimit të administratorëve zhvillohet në datën e caktuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë, i cili publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë, të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga përfundimi i afatit të publikimit të thirrjes për shprehje interesi.

2. Tarifa për pjesëmarrje në provimin e kualifikimit është 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe paguhet për llogari të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

Neni 10

Ngritja dhe funksionimi i komisionit të provimit të kualifikimit

1. Komisioni i provimit të kualifikimit ngrihet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

2. Komisioni përbëhet nga 3 përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe 2 përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Kryetar i komisionit caktohet një nga përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, që ka përvojë më të gjatë profesionale dhe në rast se të tre përfaqësuesit kanë të njëjtën përvojë profesionale, kryetar caktohet përfaqësuesi më i vjetër në moshë.

4. Komisioni mbështetet nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë Kombëtare të Falimentimit për mbarëvajtjen administrative dhe logjistike, të nevojshme për veprimtarinë e tij.

5. Përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë vendim, në veprimtarinë e komisionit zbatohen, për aq sa gjejnë zbatim, dispozitat e legjislacionit në fuqi për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.

Neni 11

Përgjegjësitë e komisionit të provimit të kualifikimit

Komisioni është përgjegjës për:

- a) hartimin e tezave të provimit dhe përgjigjeve të tyre;
- b) vlerësimin me pikë të përgjigjeve në provim;
- c) shqyrtimin e ankimeve nga kandidatët ndaj rezultateve të publikuara;
- ç) shpalljen e rezultateve përfundimtare të provimit të kualifikimit.

Neni 12

Deklarata e konfliktit të interesit

1. Pas njohjes me listën e kandidatëve të kualifikuar, anëtarët e komisionit nënshkruajnë një deklaratë personale se nuk ndodhen në rastet e pengesave ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative me kandidatët për administrator që marrin pjesë në provim.

2. Kur anëtari ndodhet në një nga këto raste, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative për përjashtimin dhe zëvendësimin e tij.

Neni 13

Provimi i kualifikimit për administrator

1. Tezat e provimit hartohen me qëllim matjen e njohurive të kandidatëve mbi Kodin e Procedurës Civile, Kodin Civil, legjislacionin mbi falimentimin, mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe legjislacionin që lidhet me të.

2. Provimi përmban pyetje me alternativa dhe me zhvillim, prej të cilave 2/3 janë me alternativa dhe 1/3 me zhvillim.

3. Vlerësimi i provimit të kualifikimit bëhet me maksimumin e mundshëm 100 (njëqind) pikë.

4. Kandidati kalon me sukses provimin e kualifikimit kur ka marrë të paktën 70 (shtatëdhjetë) pikë.

Neni 14

Përgatitja e pyetjeve të provimit dhe përgjigjet

1. Pyetjet e provimit dhe përgjigjet e tyre përgatiten nga komisioni jo më herët se 1 (një) ditë para datës së zhvillimit të provimit dhe nuk u bëhen të ditura personave të tjerë.

2. Pyetjet hartohen në 3 (tri) teza të ndryshme dhe futen në zarfe të ndryshme prej të cilave zgjidhet njëri nga zarfet për t'u përdorur në provim. Të gjitha zarfet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit. E njëjta procedurë ndiqet edhe për përgjigjet e tezave të provimit.

3. Zgjedhja e zarfit bëhet me short ditën e zhvillimit të provimit dhe në prani të kandidatëve. Zarfi duhet të jetë i mbyllur dhe i nënshkruar.

Neni 15

Paraqitja dhe identifikimi i kandidatëve

1. Hyrja për në mjediset e brendshme të zhvillimit të provimit bëhet 1 (një) orë përpara orarit të njoftuar për zhvillimin e provimit dhe identifikimi i kandidatëve bëhet në bazë të një dokumenti identifikimi personal të vlefshëm dhe me fotografi, i cili mund të jetë letërnjoftim ose pasaportë. Kandidatët, që nuk kanë mjet identifikimi të vlefshëm, përjashtohen nga pjesëmarrja në provim, për të cilën mbahet procesverbali përkatës.

2. Kandidatët ftohen të zënë vendet sipas një përzgjedhjeje rastësore nga personat e caktuar për mbikëqyrjen e provimit dhe për asnjë arsye nuk lejohen të ndryshojnë vendin e caktuar ose të dalin jashtë.

Neni 16

Përzgjedhja dhe shpërndarja e tezës së provimit

1. Zarfi i zgjedhur, sipas pikës 3, të nenit 14, të këtij vendimi, hapet nga komisioni dhe teza e përzgjedhur u bëhet e ditur publikisht kandidatëve nga kryetari i komisionit.

2. Kandidatëve u shpërndahet teza e provimit dhe fleta e përgjigjeve. Teza e provimit nënshkruhet nga komisioni dhe përmban kodin e provimit. Kodi i provimit është një numër me dy ose më tepër shifra dhe unik për çdo kopje të provimit dhe për çdo kandidat.

3. Kandidatët plotësojnë kodin e provimit në fletën e përgjigjeve, si dhe përbri emrit të tyre në një fletë të posaçme të vënë në dispozicion nga personat e caktuar për mbikëqyrjen e provimit, e cila mbyllet në një zarf të veçantë.

Neni 17

Rregullat e sjelljes gjatë zhvillimit të provimit

1. Përpara fillimit të provimit, personat e caktuar për mbikëqyrjen e provimit udhëzojnë kandidatët për zbatimin e rregullave të sjelljes gjatë zhvillimit të provimit.

2. Pas këtij njoftimi, kandidatët plotësojnë një deklaratë me shkrim se u njohën me rregullat, dhe se shkelja e tyre përbën shkak për skualifikimin e menjëhershëm nga provimi. Refuzimi për nënshkrimin e deklaratës apo kundërshtimi i përmbajtjes së saj sjell humbjen e menjëhershme të së drejtës për të kryer provimin.

3. Kandidati që gjatë provimit nuk respekton udhëzimet e dhëna, njoftohet pa paralajmërim të ndërpresë provimin dhe të lërë menjëherë sallën, duke iu komunikuar edhe skualifikimi nga procedura e provimit.

4. Në tezën e provimit dhe fletën e përgjigjeve të kandidatit të skualifikuar, sipas pikës 3, të kësaj dispozite, bëhet shënimi “Skualifikohet”, vihet në dijeni kryetari i komisionit dhe bëhet pasqyrimi në procesverbalin e provimit, ku shënohet nxjerrja jashtë procesit të vlerësimit të tezës së kandidatit të skualifikuar, si dhe shkaqet që kanë çuar në skualifikimin e kandidatit.

5. Procesverbali i provimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe bëhet pjesë e dosjes për procedurat e zhvilluara, duke i bashkëlidhur tezat e provimeve dhe fletët e përgjigjeve të kandidatëve të skualifikuar.

Neni 18

Procedura pas përfundimit të provimit

1. Pas përfundimit të kohës së caktuar për provimin, mbledhen fletët e përgjigjeve të provimit të kandidatëve dhe, nëse është rasti, bëhen shënimet përkatëse sipas parashikimeve të mësipërme.

2. Pas dorëzimit nga të gjithë kandidatët të fletëve të përgjigjeve të provimit, hapet zarfi ku ndodhen dy kopje me përgjigjet e tezës.

3. Komisioni administron njërën nga kopjet e përgjigjeve, ndërsa kopja tjetër publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 19

Korrigjimi i provimit dhe vlerësimi me pikë

1. Komisioni korrigjon provimet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e përfundimit të provimit. Secili prej anëtarëve të komisionit kryen vlerësimin e pavarur të çdo testi dhe në fund përlogariten pikët mesatare të të gjithë anëtarëve për çdo pyetje. Në fund të korrigjimit, komisioni përlogarit shumën totale të pikëve të fituara nga çdo kandidat.

2. Administrimi i rezultateve të përfituara nga korrigjimi dokumentohet me procesverbal nga një prej anëtarëve të komisionit, që zgjidhet nga kryetari. Anëtarët e komisionit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve në mbledhje.

3. Vlerësimi i provimeve nënshkruhet në çdo fletë nga të gjithë anëtarët e komisionit. Rezultatet e vlerësimit pasqyrohen në një listë, e cila përmban kodin dhe përbri pikët vlerësuese, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

4. Pas nënshkrimit të listës me kodet dhe pikët e vlerësimit për të gjitha provimet e korrigjuara, hapet zarfi me emrat dhe kodet e kandidatëve dhe përbri emrit dhe kodit të çdo kandidati shënohen pikët e fituara.

Neni 20

Publikimi i rezultateve të provimit

Lista me emrat, kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Një kopje e saj, e cila përmban vetëm kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët, publikohet brenda ditës në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë. Për efekt ankimi, publikimi është i barasvlershëm me njoftimin e çdo kandidati.

Neni 21

Ankimi ndaj rezultateve të provimit

Kandidatët, që kanë vërejtje për vlerësimin e provimit, kanë të drejtë të paraqesin ankim brenda 3 (tri) ditëve nga dita e publikimit të listës. Komisioni shqyrton ankimet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas kalimit të këtij afati dhe njofton ankuesin mbi shqyrtimin e ankimit përmes portalit qeveritar “*e-Albania*”.

Neni 22
Lista përfundimtare e fituesve

Komisioni, pas kalimit të afatit të ankimit apo shqyrtimit të ankimeve të paraqitura, sipas nenit 21, të këtij vendimi, përgatit listën përfundimtare të fituesve të provimit, e cila publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit dhe të Ministrisë së Drejtësisë. Lista përfundimtare publikohet sipas renditjes së pikëve dhe kodit të provimit për secilin kandidat, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

SEKSIONI 3
DHËNIA E LICENCËS

Neni 23
Pajisja e kandidatëve fitues me licencë

1. Kandidatët fitues, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga publikimi i listës përfundimtare të fituesve, paraqesin vërtetimin për kryerjen e pagesës së tarifës, sipas pikës 4, të këtij neni, dhe pajisen me licencë.
2. Licenca lëshohet edhe elektronikisht me vulë/nënshkrim elektronik përmes portalit qeveritar "*e-Albania*".
3. Licenca e administratorit ka afat 3-vjeçar dhe i jep të drejtë kandidatit fitues të ushtrojë profesionin e administratorit në Republikën e Shqipërisë.
4. Tarifa për pajisjen me licencë është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe paguhet për llogari të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

Neni 24
Regjistrimi i licencës

1. Agjencia Kombëtare e Falimentimit regjistron menjëherë licencën për administrator në Regjistrin e Administratorëve.
2. Agjencia njofton gjykatat e falimentimit dhe strukturën përgjegjëse për administrimin e regjistrit elektronik të ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë për licencën e lëshuar.

Neni 25
Rinovimi i licencës

1. Licenca rinovohet në bazë të kërkesës me shkrim të administratorit, e cila depozitohet në Agjencinë Kombëtare të Falimentimit, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike përpara datës së mbarimit të afatit të vlefshmërisë së saj.
2. Kërkesa shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:
 - a) kopjen e dokumentit të identifikimit;
 - b) deklaratën e kërkuarit se vazhdon të plotësojë kriteret për mbajtjen e licencës;
 - c) dokumentacionin për aktivitetet e kryera në fushën e falimentimit, për të paktën 3 (tre) vjetët e fundit;
 - ç) deklaratën se ka marrë pjesë në trajnime vazhduese profesionale dhe/ose kurse në fushën e falimentimit të organizuara nga Agjencia;
 - d) deklaratën se kërkuari nuk ka qenë subjekt i ndonjë mase disiplinore;
 - dh) vërtetimin e pagesave për detyrimet e përcaktuara nga Agjencia gjatë procedurës së mbikëqyrjes profesionale;
 - e) vërtetimin që provon pagesën e tarifës për rinovimin e licencës.

3. Tarifa për rinovimin e licencës është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe paguhet për llogari të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit.

4. Kërkesa për rinovimin e licencës shqyrtohet nga struktura përgjegjëse në Agjencinë Kombëtare të Falimentimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së saj, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

5. Kur administratori nuk ndjek procedurën sipas këtij neni, ai trajtohet si kandidat për administrator.

KREU III PROCEDURA PËR HEQJEN E LICENCËS

Neni 26

Heqja e licencës

Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të administratorit bëhet me urdhër të drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, kur administratori:

- a) heq dorë nga ushtrimi i profesionit të administratorit, me kërkesën e tij;
- b) humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) është dënuar pas marrjes së licencës me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ç) vërtetohet se në momentin e marrjes së licencës e ka marrë atë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- d) ka kryer shkelje të rënda të konstatuara nga Agjencia Kombëtare e Falimentimit gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjes.

Neni 27

Procedura për heqjen e licencës

1. Struktura përgjegjëse, në kuadër të mbikëqyrjes dhe kontrollit periodik të administratorëve, bën verifikimin e çdo informacioni të nevojshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, në rast se konstaton një nga rastet e parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 26, të këtij vendimi, i propozon drejtorit fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

2. Drejtori, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e marrjes së propozimit, udhëron fillimin e procedurës administrative dhe kryen hetimin administrativ, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative.

3. Në përfundim të procedurës administrative, drejtori vendos për heqjen e licencës, kur vërtetohen kushtet e përcaktuara në nenin 26, të këtij vendimi. Urdhri i drejtorit për heqjen e licencës ka formë të shkruar në letër dhe hartohet në përputhje me nenet 99 dhe 100 të Kodit të Procedurës Administrative.

Neni 28

Njoftimi i urdhrin për heqjen e licencës

1. Agjencia Kombëtare e Falimentimit njofton administratorin, gjykatat e falimentimit dhe strukturën përgjegjëse për administrimin e regjistrit elektronik të ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë mbi urdhrin për heqjen e licencës.

2. Heqja e licencës pasqyrohet në Regjistrin e Administratorëve.

Neni 29

Ankimi

Administratori ka të drejtë të paraqesë ankim ndaj urdhrit për heqjen e licencës në gjykatën administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 30 **Shfuqizime**

Fjalja e dytë, e pikës 14, të vendimit nr. 542, datë 19.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit”, shfuqizohet.

Neni 31 **Organet zbatuese**

Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Falimentimit për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 32 **Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku